

Datës-izlaze:

Nr. 1-15  
Br.

Data 04.02.2022  
Datum.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosova**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq**

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës së DPUKP-së, nr. -V- 2151, të dt.14.01.2022, në mbledhjen e mbajtur me dt.31.01.2022, mori këtë:

## V E N D I M

1. Themelohet Komisioni komunal për shqyrtim të kërkesave për emërtim të rrugëve me këtë përbërje:
  - 1.1 Edin Hashani , Kryetar-DPUKP
  - 1.2 Skënder Mjekiqi, anëtar- DPUKP
  - 1.3 Bajram Hashani, anëtar i Kuvendit
  - 1.4 Shaip Paloja, anëtar i Kuvendit
  - 1.5 Lulzim Preniqi , anëtar i Kuvendit
2. Komisioni në fjalë do të bëjë zgjerimin e listës rezervë të emërtimeve apo adresave duke përfshirë tërë territorin e Komunës së Obiliqit.
3. Emërtimi i këtyre rrugëve do të bëhet për banorët e fshatit Hade dhe fshatrave tjera të cilët janë atakuar nga procesi i shpronësimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për zgjerimin e Mihjeve të Thëngjillit të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe kërkesave tjera në tërë teritorin e Komunës.
4. Obligohet Komisioni që për punën e vet të përgatitë procesverbal me shkrim dhe për këtë ta njoftoj Kuvendin komunal.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T' idërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesuesit
- DPUKP
- Anëtarëve të KK
- Anëtarëve të Komisionit
- MAPL
- Arkivit

Kryesuese e Kuvendit Komunal  
*Vlora Mjekiqi Kabashi*  
Vlora Mjekiqi Kabashi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRQJITHSHME  
ZEMËRJA QËNDE ADMINISTRACIJE  
Data/Idari: Nr. V-2151 Data 14.01.2022  
Sr. Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Drejtoria per Planifikim Urban Prone dhe Kadastër

Datë/Data/Date	13/01/2022
Nga/Od/From:	Arben Berisha-Drejtor i DPUKP-së
Permes/Preko/through	z.Xhafer Gashi – Kryetari i Komunës
Për/Za/To:	Kuvendin Komunal
Tema/Subjekat/Subjeckt:	Kërkesë



Të nderuar !

Bazuar në Ligjin 04\L-071 për Sistemin e Adresave neni 7 kërkojmë nga ana e juaj si Kuvend Komunal që të formoni një Komision për emërtimin e rrugëve në lagjen " Hade e re" për arsye se në atë zonë nuk është realizuar ende projekti i vendosjes së emrave apo adresave të rrugëve dhe numërtimi i shtëpive .

Komisioni në fjalë do të bëjë po ashtu zgjerimin e listës rezervë të emërtimeve apo adresave duke përfshirë gjithë territorin e Komunës sonë .

Pra , emërtimi i këtyre rrugëve do të bëhet për banorët e fshatit Hade të cilët janë atakuar nga procesi i Shpronësimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës për zgjerimin e Mihjeve të Thëngjillit të Korporatës Energjetike të Kosovës .

Me respekt !